



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr867/11_Prot.

Tiranë, më 23.12.2017

V E N D I M

Nr.190, Datë 23.12.2017

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT "MBI
ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË
VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE NË ZBATIMIN E
PROJEKTEVE "GJELBËRIMI I SHËTITORES SË VIJËS BREGDETARE TË
VLORËS" DHE "MBUSHJA ME RËRË E PLAZHIT VLORË"
PËR PERIUdhËN E ZBATIMIT TË TYRE.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të IT dhe Projekteve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare në zbatimin e projekteve "Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare të Vlorës" dhe "Mbushja me rërë e Plazhit Vlorë", të ushtruar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, sipas programit të auditimit nr.867/5 prot, datë 11.09.2017, miratuar nga Kryetari i KLSH, për periudhën e realizimit të këtyre projekteve.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon

A. Opinion i Auditimit

Konkluzionet dhe baza për opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 4000¹). Nga auditimi i përputhshmërinë², për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet aktiviteti (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, gjatë auditimit të projekteve “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare të Vlorës” dhe “Mbushja me rërë e Plazhit Vlorë”, janë konstatuar mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator (*kriteret*), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale, duke justifikuar dhënien e *një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë*³.

Baza për kualifikimin e Opinionit

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI) dhe konkretisht ISSAI 4000 “Standarti i Auditimit të Përputhshmërisë”. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin.

Ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Ne sjellim në vëmendjen se në të gjitha procedurat e prokurimit, të projekteve “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, “Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës”, “Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës” dhe “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare Vlorë”, Njësia e Prokurimit nuk ka analizuar dhe nuk ka dokumentuar përlogaritjen e fondit limit, duke lenë vend për devijime nga fondi limit real dhe për përfshirjen e shpenzimeve të pajustificuara. U konstatuan devijime me efekte financiare negative të shkaktuara nga vendimmarrja në fushën e prokurimeve publike në vlerën 25,111,774 lekë dhe dëm ekonomik për shkak të devijimeve në fushën e zbatimit të kontratave në vlerën 9,234,043 lekë.

Gjatë zbatimit të objektit “Mbrojtje detare e projektit të mbushjes me rërë e plazhit të Vlorës” u konstatua ndryshimi i gjurmës dhe vendosjes së gjeokononierëve përgjatë bregut të plazhit të Vlorës”, në krahasim me gjurmën dhe vendosjen e përcaktuar në projektin fillestar.

¹ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

²Mbeshtetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

³ISSAI 4000 - 4200 - Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Është konstatuar se projektimi dhe mbikëqyrja e objektit “Mbrotja detare e mbushjes me rërë të plazhit të Vlorës” është bërë pa kosto financiare nga shoqëria I, por nga ana e FSHZH nuk është lidhur kontratë me këtë shoqëri, ku të përcaktohen detyrimet dhe të drejtat e palëve. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 5 dhe 7 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 19-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që në çdo rast, për projektimin apo mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, të kontraktojë persona fizikë apo juridikë të pajisur me licencë profesionale, pasi mungesa e kontratës eliminon të drejtën juridike të ngarkimit me përgjegjësinë potenciale në hartimin e projekt-preventivit dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi është konstatuar se disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit në lidhje me kapacitetet teknike (stafi teknik) dhe profesionale (kategoritë e licencave profesionale) të OE, janë diskriminuese, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, si dhe nuk përputhen me natyrën e punimeve dhe volumet e preventivit. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 11-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Strukturat e caktuara për vendosjen e kriterëve të kualifikimit, të marrin masa që të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë dhe që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre dhe të përputhen në natyrë dhe sasi me preventivat e objekteve që prokurohen.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në kontratën e firmosur nga ana e titullarit të AK për objektin “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, është dhënë pagesë paraprake në vlerën 17,992,800 lekë, ndërkohë që në Kushtet e Veçanta të Kontratës (DST) është përcaktuar që Kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake. Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Dokumentet Standarde të Tenderit, në nenin 59 dhe nenin 60 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe Udhëzimin e MF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. *(Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen të zbatojë kushtet e veçanta të kontratës të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, duke i ruajtur ato

në lidhjen e kontratës me Operatorin Ekonomik fitues, duke siguruar në këtë mënyrë trajtimin e barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë të interesuar për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se në të gjitha procedurat e prokurimit, “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, “Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës”, “Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës” dhe “Gjelbërimi i shëtitores së vijës bregdetare Vlorë” Njësia e Prokurimit nuk ka analizuar dhe nuk ka dokumentuar përlllogaritjen e fondit limit, duke lenë vend për devijime nga fondi limit real dhe për përfshirjen e shpenzimeve të pajustificuara. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 10-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Njësia e Prokurimit, të marrë masa që përpara hartimit të Urdhrit të Prokurimit, të bëjë analizën e kostos së objekteve që prokurohen, me qëllim hartimin e fondit limit sa më real dhe ndikimin pozitiv në përdorimin e fondeve publike me ekonomikitet.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se për objektin “Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës” me vlerë 92,400 Euro (rreth 12,936,000 lekë) pa tvsh, është propozuar lloji i procedurës së prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. Ky objekt prokurimi është trajtuar nga ana e Autoritetit Kontraktor si shtesë kontrate, duke marrë në konsideratë si kontratë fillestare “Projekti teknik i Vijës Bregdetare Vlorë”, me argumentimin e riskut të lartë që paraqitet gjatë zbatimit, natyrën e veçantë të këtij projekti, specifikimet teknike, nevojën e veçantë për një shërbim kompetent me stafin e kualifikuar që ka bërë studimin dhe zgjidhjen e projektit, si dhe zgjidhjen racionale teknike të paparashikuar që konsulenca e Projektimit i ka dhënë këtij projekti. Lloji i procedurës së përzgjedhur nga Autoriteti Kontraktor është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.10.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 33, pika 5/a dhe nenin 36, pika 2 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, pasi kemi të bëjmë me dy objekte prokurimi të ndryshme. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 27-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor të marrë masa për përzgjedhjen e llojit të duhur të procedurës së prokurimit, duke preferuar vazhdimisht procedurën e hapur, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes teknike të objektit “Mbrojtje detare e projektit të mbushjes me rërë e plazhit të Vlorës” dhe i korrespondencës midis FSHZH, “I” dhe kontraktorit, konstatohet se për shkak të

mosplotësimin të dosjes nga ana e kontraktorit, objekti nuk është kolauduar ende, në mospërputhje me Nenin 12 të Ligjit 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ndonëse punimet kanë përfunduar më datë 31.08.2016 dhe është lidhur kontratë për kolaudimin e punimeve në datë 02.11.2015, me vlerë 99,900 lekë pa tvsh, me operatorin “A&E”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.46-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

7.1 Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marrë masa për kolaudimin e objektit dhe të fillojë procedurat për penalizimin e kontraktorit sipas legjislacionit në fuqi, për mosvënie në dispozicion të gjithë dokumentacionit teknik të nevojshëm për kolaudimin e objektit.

Brenda datës 31.01.2018

8. Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të objektit “*Mbrojtje detare e projektit të mbushjes me rërë e plazhit të Vlorës*” u konstatua ndryshimi i gjurmës dhe vendosjes së gjeokononierëve përgjatë bregut të plazhit të Vlorës”, në krahasim me gjurmën dhe vendosjen e përcaktuar në projektin fillestar. Megjithëse nuk ka ndryshuar nga ana sasiore preventivi, autoriteti kontraktor nuk ka kryer asnjë urdhër ndryshimi ose amendim kontrate për këtë fakt. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 46-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

8.1 Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit të miratojë të gjithë ndryshimet e projekteve, edhe pse nuk ndryshojnë sasinë dhe volumet e preventivit të hedhur në tender, vetëm nëpërmjet urdhër ndryshimeve dhe amendimit të kontratave.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren u konstatua se mungonin tre pemë palma të llojit Washington h=500÷600 cm me vlerë 121,125 lekë, në pjesën ku bashkohet rruga e Lungomares me sheshin e mbiquajtur “Rrapi”. Sipas një dokumentit të siguruar nga menaxheri i kontratës, kontraktori “G L” sh.p.k ka bërë kallëzim në Policinë Gjyqësore, datë 14.08.2017, në lidhje me dëmtimin e tre palmave përgjatë “Lungomares”. Dita e kallëzimit është pas datës së kolaudimit të objektit dhe paraqitjes së situacionit përfundimtar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.52-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

9.1 Rekomandimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, duke qenë se objekti është ende brenda garancisë së punimeve, të marrë të gjitha masat që operatori ekonomik “G L”sh.p.k, të zëvendësojë palmat e munguara.

Brenda datës 28.02.2018

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se FSHZH nuk ka bërë kërkesë për financimin e projektit “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë e plazhit të*

Vlorës” në Fondin për Zhvillimin e Rajoneve 2014. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Nga ana e FSHZH të merren masa që për projektet e parashikuara në planin e investimeve, të bëhet kërkesë për financim pranë donatorëve apo Qeverisë Shqiptare, shoqëruar me raportet e vlerësimit për çdo projekt.

Menjëherë dhe në vijimësi

C.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të objektit “Mbrotjtje detare e projektit të mbushjes me rërë e plazhit të Vlorës”, u konstatua se operatori ekonomik “S.C.P.A” ka përfituar më tepër vlerën **5,156,827 lekë me tvsh**, për punime të pakryera, në kundërshtim me Ligjin 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. (Trajtuar më hollësisht në faqet nr 46-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Fondit Shqiptar i Zhvillimit të ndjekë të gjithë procedurat administrative dhe ligjore për kthimin në Buxhetin e Shtetit të vlerës prej **5,156,827 lekë me tvsh** nga operatori ekonomik “S.”.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të objektit “Gjelbërimi i shëtitores së vijës bregdetare Vlorë” u konstatua se është paguar dy herë nga ana e Autoritetit Kontraktor, në favor të firmës “G L Sh.p.k”, sasia prej 35 pishave, me vlerë **2,310,000 lekë me tvsh**, ndërkohë që kjo vlerë, në bazë të kontratës të lidhur midis AK dhe OE, duhet të ishte mbuluar nga policia e sigurimit. (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 52-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Fondit Shqiptar i Zhvillimit të ndjekë të gjithë procedurat administrative dhe ligjore për kthimin në Buxhetin e Shtetit të vlerës prej **2,310,000 lekë me tvsh** nga operatori ekonomik “G L Sh.p.k”.

Menjëherë

C.2 MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Projekti i objektit “Gjelbërimi i shëtitores së vijës bregdetare Vlorë”, hartuar pa kontratë nga shoqëria I, është pjesë e projektit “Vija bregdetare e

Vlorës, Lungomare”, i cili në përmbledhësen e preventivit, për pjesën e gjelbërimit ka vetëm dy zëra pune:

1. *Pemë tipi pinus halepensis me lartësi 600 cm (830 pemë x 600 euro/pemë), 498,000 Euro*

2. *Pemë pseudoacacias (300 pemë x 400 euro/pemë), 120,000 Euro*

Në total 618,000 Euro ose rreth 86,520,000 lekë, aq sa është përcaktuar fondi limit i këtij objekti. Pra përlllogaritja e fondit limit nga Autoriteti Kontraktor është bërë sipas projekt-preventivit “Vija bregdetare e Vlorës, Lungomare”, pjesa e gjelbërimit.

Në preventivin e hedhur në tender përcaktohen 662 pemë pinus halepensis, ose 168 pemë më pak se projekti fillestar (168 x 55000 lekë/pemë = 9,240,000 lekë të parashikuara për tu investuar më pak) dhe 364 pemë pseudoacacias, ose 64 pemë të parashikuara për tu investuar më shumë se projekti (64 x 16780 lekë/pemë = 1,673,080 lekë të parashikuara për tu investuar më shumë).

Nga sa sipër, në këtë objekt, me te njëjtën vlerë të preventivuar nga projektuesi, **janë prokuruar 8,166,080 lekë (-9,240,000+1,673,080) volume punimesh më pak se projekti, i cili konsiderohet efekt negativ në Buxhetin e Shtetit.** (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 36-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nisur nga fakti që në këtë institucion menaxhohen investime të rëndësishme dhe me vlera të konsiderueshme, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të marrë masa që para nxjerrjes së Urdhrit të Prokurimit, të analizojnë kostot e objekteve, për të patur prokurime të punëve publike në vlerat reale të tyre.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës”, me fond limit 29,550,381 lekë pa tvsh, është shpallur fitues OE “Kostruttiva” s.c.p.a. me ofertë ekonomike 29,435,994 lekë pa tvsh, ose 99.6% e fondit limit.

- OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e dhëna në DT:

- Nga verifikimi në SEP i dokumentacionit të paraqitur nga BOE e skualifikuar “L”shpk & ”N”shpk & “B S”shpk, rezulton se argumentet e paraqitura nga KVO për skualifikimin e këtij BOE, kanë të bëjnë me mospagimin e detyrimeve nga OSHEE për muajin Korrik 2015 dhe nga një OE pjesëmarrës në BOE, nuk është paraqitur pagesa e taksës vendore në Komunën Markat.

Nisur nga sa sipër, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë, kanë mangësi në dokumentacion dhe sipas Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 46 dhe 53, pika 3, duheshin skualifikuar. Në zbatim të nenit 73, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor duhet të ndërpriste procedurën dhe të fillonte një procedurë të re prokurimi.

KVO ka përdorur standard të dyfishtë në vlerësimin e operatorëve pjesëmarrës në tender, duke bërë kualifikim të padrejtë të OE “K”. Nëse do të përdorte të njëjtin standard, KVO duhet të kishte kualifikuar edhe BOE “L” shpk & ”N” shpk & “B S” shpk, duke e

nxjerrë fitues me vlerën 25,416,300 lekë, ose 4,009,694 lekë më pak se oferta e OE fitues, vlerë e cila do të ishte kursim në Buxhetin e Shtetit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 23-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: FSHZH të analizojë, nëpërmjet strukturës së Auditit të Brendshëm, përgjegjësitë për përdorimin e standardit të dyfishtë në këtë procedurë prokurimi, në mënyrë që në të ardhmen, vlerësimet e ofertave të sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Me Urdhrin e prokurimit nr. 4/1, datë 11.01.2015, për objektin “Shërbimi i supervizimit për mbushjen me rërë të plazhit të Vlorës”, është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor procedura e prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, me arsyen e përdorimit “Ligji nr. 9643, datë 20.10.2006, neni 33, pika 5/a”.

Zbatimi i nenit 33, pika 5/a të Ligjit nr. 9643, datë 20.10.2006, shtesa e kontratës nëpërmjet procedurës “Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, mund të bëhet vetëm kur kontratës fillestare i ndryshojnë faktorët “kohë” / “vlerë” dhe i mbeten të pandryshuar faktorët “objekt” dhe “Palë”. Në rastin në fjalë, kontrata e quajtur “fillestare” nga ana e AK, ka objekt “Projektimi i vijës bregdetare të Vlorës, Lungomare”, ndërsa kontrata që po shqyrtojmë ka objekt “*Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, pra janë dy objekte prokurimi të ndryshme. Në këto rrethana, vlera prej 92,400 Euro (rreth 12,936,000 lekë) pa tvsh është shpenzim joefektiv.

3.1. Rekomandimi: FSHZH të analizojë, nëpërmjet strukturës së Auditit të Brendshëm, përgjegjësitë për përzgjedhjen e kësaj procedure dhe të marrë masa që në të ardhmen zgjedhja e procedurës së prokurimit në objektet që realizohen me fondet e Buxhetit të Shtetit të bëhet sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar të prokurimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” si dhe pikës 377, germa a, b, c dhe d, të Manualit të Procedurave të FSHZH-së, i rekomandoj Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH-së, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” deri në “Kalim në detyrë apo nivel page më të ulët nga 30 ditë deri në 1 vit”, në zbatim të nenit 12 të Kontratës individuale të punës, për personat si më poshtë:

1. Tritan Brahimaj me detyrë Drejtor i Infrastrukturës, pasi:

- në cilësinë e Kryetarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, ka kualifikuar BOE “C V C. shpk me mangësi në

dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e Drejtorit të Infrastrukturës, ka propozuar procedurën e prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, për objektin “Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.10.2006, neni 33, pika 5/a dhe për pasojë është kryer shpenzim joefektiv me vlerë 92,400 Euro pa tvsh.

- në cilësinë e Kryetarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare Vlorë”, ka kualifikuar OE “G ” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2. E O me detyrë Koordinator i KFW, pasi:

-në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, ka kualifikuar BOE “CV C” & R me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “*Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, është pranuar si fitues operatori Ekonomik X, i cili nuk plotëson kërkesat e kërkuara në Dokumentet e Tenderit, në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare Vlorë”, ka kualifikuar OE “G” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3. E Q, me detyrë përgjegjës i Njesisë së Projekteve të Infrastrukturës Rrugore, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, ka kualifikuar BOE “C V C” s.c.p.a. & Riviera shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e Përgjegjësit të Njesisë së Projekteve të Infrastrukturës Rrugore, ka propozuar procedurën e prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, për objektin “Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.10.2006, neni 33, pika 5/a dhe për pasojë është kryer shpenzim joefektiv me vlerë 92,400 Euro pa tvsh.

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare Vlorë”, ka kualifikuar OE “G” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4. D M, me detyrë specialist i Njesisë së Projekteve të Infrastrukturës Rrugore, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, ka kualifikuar BOE “C V C”. & Riviera shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;
- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, ka kualifikuar OE “Konstruktiva” s.c.p.a. me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;
- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “*Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, ka pranuar si fitues operatori Ekonomik X, i cili nuk plotëson kërkesat e kërkuara në Dokumentet e Tenderit, në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;
- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare Vlorë”, ka kualifikuar OE “G” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 10-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5. L M me detyrë përgjegjës i Njesisë së Projekteve Hidroteknike, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, ka kualifikuar BOE “C V C” & R shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;
- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, ka kualifikuar OE “K. me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;
- në cilësinë e kryetarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “*Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, ka pranuar si fitues operatori Ekonomik X, i cili nuk plotëson kërkesat e kërkuara në Dokumentet e Tenderit, në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;
- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare Vlorë”, ka kualifikuar OE “G” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 10-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6. Artian Plasari, me detyrë specialist i Njesisë së Prokurimeve, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, ka kualifikuar OE “K” s.c.p.a. me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

7. VK, me detyrë përgjegjës i Njesisë së Prokurimeve, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, nuk ka analizuar përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, koston e punëve të këtij objekti;

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, nuk ka bërë dokumentimin e përlllogaritjes së fondit limit përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit dhe ka bërë shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave me 10 ditë, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2/1, të nenit 42 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”;

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare Vlorë”, nuk ka analizuar përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, koston e punëve të këtij objekti dhe për pasojë në këtë objekt, me te njëjtën vlerë të preventivuar nga projektuesi, janë prokuruar 8,166,080 lekë volume punimesh më pak se projekti.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8. A Z, me detyrë specialist i Njesisë së Prokurimeve, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, nuk ka analizuar përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, koston e punëve të këtij objekti;

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, nuk ka bërë dokumentimin e përlllogaritjes së fondit limit përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit dhe ka bërë shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave me 10 ditë, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2/1, të nenit 42 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”;

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare Vlorë”, nuk ka analizuar përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, koston e punëve të këtij objekti dhe për pasojë në këtë objekt, me te njëjtën vlerë të preventivuar nga projektuesi, janë prokuruar 8,166,080 lekë volume punimesh më pak se projekti. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9. M M, me detyrë specialist i Njesisë së Prokurimeve, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, nuk ka analizuar përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, koston e punëve të këtij objekti;

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare Vlorë”, nuk ka analizuar përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, koston e punëve të këtij objekti dhe për pasojë në këtë objekt, me te njëjtën vlerë të preventivuar nga projektuesi, janë prokuruar 8,166,080 lekë volume punimesh më pak se projekti. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10. M J, me detyrë specialist i Njesisë së Prokurimeve, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, nuk ka bërë dokumentimin e përlllogaritjes së fondit limit përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit dhe ka bërë shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave me 10 ditë, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2/1, të nenit 42 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 10-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Shënim: Për punonjësit M Xh, E Xh, E Z, A L, A K, V P dhe P I, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të hartimit të kriterëve teknike, nuk kemi rekomanduar masa administrative apo disiplinore, pasi mangësitë e konstatuara nuk përbëjnë bazë materialiteti për dhënien e masës disiplinore.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të IT dhe Projektve të Huaja

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R